



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 756 Prot

Vlorë, më 28.3.2018

VENDIM

Nr. 18, datë 21.03.2018

PROPOZIM PËR SHPALLJE “ DËSHMOR I ATDHEUT”

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 21.03.2018 në zbatim të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, Ligjit Nr. 8607, datë 27.04.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 151, datë 25.04.2002 Për Statusin “Dëshmor i Atdheut” (i ndryshuar), Udhëzimit Nr. 1803, datë 10.06.2002 Për zbatimin e V.K.M-së Nr.151, datë 25.04.2002 për Statusin “Dëshmor i Atdheut” si dhe Vendimit Nr.01, datë 13.02.2018 të Komisionit për Statusin e “Dëshmorit të Atdheut“ pranë Këshillit të Qarkut Vlorë;

VENDOSI;

- 1.Ti propozoj Komisionit Qëndror të Statusit “Dëshmorit i Atdheut“ Tiranë, shpalljen “Dëshmor i Atdheut“ të të ndjerit Hulusi Ferhat DIZDARI, i datëlindjes 1903, pjesë e batalionit “Çamëria”, vrarë më 15 korrik 1944.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari, Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve pranë Këshillit të Qarkut Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretar i Këshillit të Qarkut

Vllasi Nasaj

Jurist

Alma Myrtaj





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË**

**RELACION**

**Të Nderuar Këshilltarë!**

Komisioni për Statusin e “Dëshmorit të Atdheut” pranë Këshillit të Qarkut Vlorë, i mbledhur më datë 13.02.2018 ora 11:00 në ambjentet e Këshilli të Qarkut Vlorë, në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr. 8607, datë 27.04.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut” i ndryshuar, VKM - së Nr. 151, datë 25.04.2002 për Statusin “Dëshmor i Atdheut” i ndryshuar, si dhe Udhëzimit Nr. 1803, datë 10.06.2002 për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 151, datë 25.04.2002 për Statusin “Dëshmor i Atdheut” pika II, shqyrtoi kërkesën e familjarëve të të ndjerit Hulusi Ferhat DIZDARI për shpalljen e tij “Dëshmor i Atdheut”.

Sipas kërkesit (djali i të ndjerit), i rëni Hulusi Ferhat Dizdari, i datëlindjes 1903, i arsimuar në shkollën “Zosimea” të Janinës ju bashkua batalionit “Çamëria”, pjesë e të cilit ishte edhe djali i tij Baftjari. Në batalionin “Çamëria” (që më pas mori emrin “Thanas Lulo”) atij i caktoj në detyrën e intendentit deri në pushkatimin e tij më datë 15 korrik 1944, në Therepel të Skraparit nga forcat partizane.

Komisioni shqyrtoi dokumentacionin shoqërues së kërkesës për shpalljen “Dëshmor të Atdheut” të të rënit dhe vendosi që dosja përkatëse (dokumentacioni) ti përcillet Komisionit Qëndror të Statusit “Dëshmor i Atdheut” Tiranë, pasi plotësohen kriteret e Ligjit Nr.8607, datë 27.04.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut” i ndryshuar.

**KOMISIONI**